

*Our Mission:
Supporting improved
educational opportunities for
the children and youth of the
isolated Malesia e Madhe
region of Northern Albania*

President: Steve Cook, PhD

Secretary: Terri Cook

Board of Directors:

Karen Berg
Mary Alice Seville
Nancy Leeper
Kristina Milaj
Mona Jones-Romansic

Albania Manager:

Marash Rakaj

Albanian Alps Institute
8600 NW Oak Creek Drive
Corvallis, OR 97330

Phone: 541-230-1285

Email: albanianalpsinst@gmail.com

Website: www.albanianalps.org

MARASH RAKAJ



Marash Rakaj, Menaxhieri Shqiptarë për Institutin e Alpeve Shqiptare, është lindur në Bogë me 4 Prill, 1963, në një familje të madhe, gjatë komunizmit. Koha e komunizmit ishte shumë e vështirë për fshatarët; shumë herë ata nuk kishin as ushqim të mjaftueshëm. Marashi shkëlqeu në shkollë dhe ishte një nga studentat e rrallë në fshat që u dërgua në universitet. Ai ndjeku Fakultetin e Shkencave Natyrore në Universitetin e Tiranës dhe u diplomua në vitin

1986 me diplome BS. Ai dha mësim në shkollën e Thethit, e cila është përtej vargmaleve që ndajnë Bogën me Thethin, duke ecur këmbë çdo javë nga Boga në Theth, nganjëherë nëpërmjet borës së thellë, duke bërë ski poshtë në malin e pjerrët. Ai më pas u transferua në Boga ku dha mësim dhe ishte Drejtor i Shkollës. Në 1990 filloi të japë mësim Botaninë në Universitetin e Shkodrës. Marashi u martua me një nga ish-nxënëset e tij, Marjeta Vata në vitin 1998. Dhe në vitin 1999 djali i tyre Gabrieli është lindur.

Pas 20 vite mësimdhënie në Universitetin e Shkodrës, ai arriti graden më të lartë, Profesor i Asociuar. Në vitin 2003 ai ishte shumë i rëndësishëm në themelimin e Institutit të Alpeve Shqiptare (AAI). Ai është “përsosur në terren” i njohur dhe i respektuar nga të gjithë në Alpet Shqiptare. Instituti i Alpeve Shqiptare i ka borxh Marashit mirënjohje të madhe për kontributin e tij të pazëvendësuar drejt organizates.

Marrësit më të ri të Bursave



Xhesika Bakaj



Ermela Celaj

Marrësit e Bursave për Vitin Shkollorë 2019-2020

Ermela Celaj – Viti i 1rë - Fin/Acctg

Xhesika Bakaj – Viti i 1rë – Fin/Acctg

Denisa Pepaj – Viti i 2të – Math Ed

Gentjan Sterkaj – Viti i 3të – Bus Adm

Santuela Vulaj – Viti i 3të - Biochemistry

Juliana Kuquaj – Viti i 3të – Fin/Acctg

Jozefina Gjollaj – Viti i 3të – Sociology

Verarta Marvukaj – Viti i 3të – Math Ed

Stelina Vulaj – Viti i 3të – Math Ed

Vana Ulaj – Shkolla e Mesme

Shenim: Programi i Diplomes Bachelor eshte tre vite.

TAKOHUNI ME ARIAN GOKAJ



Kur AAI ishte në fillimet e saj, ne vuajtme të gjenim një burim për librat dhe pajisjet shkollore, atëherë gjetëm Arian Gokaj. Ai punon shumë për të gjetur gjërat që u duhen shkollave të mbështetur nga AAI. Por gjithashtu, sic thuhet në frazën shqipe, Arian është "shumë e saktë" moralisht dhe etikisht, duke mbajtur llogari të përpikta të parave tona ndërsa ai ua jep këtë mësuesve tanë dhe studentëve të bursave. Arian jetoi shumë vite nën komunizëm, ndoqi Shkollën e Mesme Industriale duke studiuar në degën elektrike. Me rënien e komunizmit, ai ndoqi pasionin e tij - librat. Ai e hapi kancelarinë në vitin 1992 dhe është përfshirë në tregtinë e librave për këto 27 vitet e fundit. "Librat kanë qenë gjithmonë pasioni im sepse prindërit e mi më edukuan në kulturën e librit. Përpiqem të kem libra të veçantë në të gjitha fushat, sepse dua që kancelaria të ketë një emër të mirë dhe besoj se e kam arritur atë." Arian jeton në Shkodër me gruan e tij dhe ata kanë dy djem. Ne ju falënderojmë shumë Arian, për ndihmën tuaj këto vitet e kaluara në përmbushjen e misionit tonë.



Boga English Students

Check us out on Facebook



Happy Kindergartener

LETET NGA PRESIDENTI

Në këtë gazetë ne nxjerrëm në pah dy persona, përpjekjet e të cilëve prapa skenave e mbajnë organizatën tonë në funksion. Menaxheri ynë shqiptar, Marash Rakaj, do të tërhiqet paksa dhe një prej ish-marrësve të bursave tona, Rregina Rakaj, do të fillojë të ndihmojë me disa nga detyrat brenda vendit.

Programet tona vazhdojnë, ne ende po mbështesim bibliotekat në pesë shkolla pasi qeveria kombëtare siguron pak burime. Pesë kopshtet e Shkrelit kanë furnizime vetëm për shkak të përpjekjeve tona. Dhe dhjetë studentët që ne mbështesim me bursa mund të mos e kishin vazhduar universitetin pa mbështetjen e AAI. Pajisjet e këndit të lojërave përdoren, dyert dhe dritaret e dëmtuara riparohen, portat funksionojnë, vetëm për shkak të mbështetjes sone. Pas 16 vjetësh, ne akoma kemi një rol të rëndësishëm në jetën e nxënësve të zonës së Shkrelit.

Dhe sigurisht, ne ende ekzistojmë për shkak të donatorëve tanë që besojnë në atë që ne po bëjmë. Jam thellësisht e përlulur nga besimi që kanë treguar njerëzit për përpjekjet tona për të përmirësuar jetën e studentëve në malet e veriut të Shqipërisë.



Amazon Smile është një mënyrë e thjeshtë dhe automatike për të mbështetur organizatën tuaj të preferuar bamirëse, pa ju kushtuar juve asnjë lek. Kur blini në smile.amazon.com, ju do gjeni ekzaksisht të njëjtat produkte dhe çmime si në Amazon.com, por me bonus, sepse Amazon do të dhuroj 0.5% të çmimit të artikujve që ju blini për organizatën tuaj të preferuar.

Herën e parë që shkoni në smile.amazon.com, hyni një lloj si tek Amazon.com. Atëherë përzgjidhni organizatën bamirëse që ju dëshironi të mbështesni (shpresoj që të jemi ne). Amazon e mban mend zgjedhjen tuaj dhe c'do blerje e juaja nëpërmjet smile.amazon.com rezulton në një donacion nga Amazon për organizatën që ju zgjidhët.

Vetëm mbaj mend të shkoni në smile.amazon.com, hvr si zakonisht dhe vazhdoni blerien!